



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.424/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR] nga fshati Trudë, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Gjermani, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Brenda Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga fshati Trudë, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Gjermani, ZL.Anr.424/2025, e datës 09.11.2025, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Brenda Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2025.

A r s y e t i m

Më datë 09.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë ZL.Anr.424/2025 nga [REDAKTUAR] kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në të cilën pretendon se në raundin e parë të zgjedhjeve komunale është regjistruar si votues jashtë vendit në Gjermani ku ka qenë në studime. Fletëvotimi që i është dërguar nga KQZ, ankuesi thekson se ka qenë për Komunën e Prizrenit edhe pse është votues i Prishtinës. Tutje, shton se pas shqyrtimit të rastit nga KQZ, i është thënë që fletëvotimi i korrigjuar do të vijë por nuk ka ndodhur, për këtë arsye, për raundin e dytë (balotazh) ankuesi thotë se ka ardhur në Kosovë për të votuar në vendvotimin ku ka votuar gjithmonë, emri i tij nuk ka qenë në listën e votuesve dhe pretendon se i është refuzuar e drejta e votës, sipas tij pas kontaktit me KQZ është njoftuar se nuk mund të votoj fare (as me kusht) sepse është i regjistruar për votim jashtë vendit në raundin e parë (jo në balotazh). Andaj, parashtruesi i ankesës pretendon se po i shkelet e drejta bazike e çdo qytetari, e drejta e votës madje për herë të dytë. Si dëshmitarë për të vërtetuar dyshimet e tij ka përmendur disa nga familjarët e tij.

Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja, ka theksuar se bazuar në nenin 8, par.1, nën par.1.1 dhe 1.2 të LZP theksohet se: 1.KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhëna të sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë përmban: 1.1. *ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si shtetas të Kosovës sipas Ligjit për shtetësinë*; 1.2. *të gjithë shtetasit me të drejtë votë jashtë Kosovës, të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar dhe janë regjistruar për votim në përfaqësi diplomatike apo përmes*

postës, si votues jashtë Kosovës. Ndërsa në nenin 96 par.9 të LZP në lidhje me votimin jashtë Kosovës theksohet se: 96.9. KQZ secilin votues të regjistruar për të votuar nga jashtë Kosovës, e largon nga Lista e Votuesve brenda Kosovës, KQZ, ka njoftuar secilin votues të regjistruar për votim jashtë Kosovës përmes email adresës, se në momentin e aprovimit të kërkesës për regjistrim, emri i tij apo saj do të largohet nga lista e votuesve brenda Kosovës. Në nenin 7, par.6 të Rregullores nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës theksohet se 6. *Votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës, i cili kërkon të kthehet në listën votuese brenda Kosovës, ka kohë të bëjë kërkesën deri në 24 orë para përfundimit të periudhës së kundërshtimit.* Duke marrë parasysh se pala ankuese ka qenë e regjistruar për të votuar jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, atëherë pala është larguar nga Lista e Votuesve brenda Kosovës. Gjithashtu, meqenëse pala ankuese nuk ka bërë kërkesë që të kthehet në listën e votuesve brenda Kosovës, ashtu siç parashihet me nenin 7 par. 6 të Rregullores se lartcekur, rrjedhimisht palës nuk i është lejuar votimi në vendvotimin brenda Kosovës për raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune, të datës 09 nëntor 2025. Me datën 24.09.2025, KQZ i ka dërguar palës ankuese fletëvotimin e parë i cili nuk ka qenë i komunës përkatëse për të cilën ushtron të drejtën e votës. Pas komunikimit të palës ankuese me KQZ, palës i është dërguar fletëvotimi i komunës së Prishtinës të cilin pala e ka pranuar me datën 9 Tetor 2025 në ora 09:48, pra para së të përfundoj periudha e votimit jashtë Kosovës me datën 11 Tetor 2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia-PZAP-i, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, përgjigjes në ankesë dhe provave të bashkangjitura të njëjtës, vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, provat e bashkangjitura dhe përgjigjes në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar, për faktin se parashtruesi i ankesës ka qenë i regjistruar për të votuar jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, atëherë pala nga KQZ është larguar nga Lista e Votuesve brenda Kosovës. Parashtruesi i ankesës nuk ka bërë kërkesë që të kthehet në listën e votuesve brenda Kosovës, ashtu siç parashihet me nenin 7 paragrafi 6 të Rregullores nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës përcakton se *“Votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës, i cili kërkon të kthehet në listën votuese brenda Kosovës, ka kohë të bëjë kërkesën deri në 24 orë para përfundimit të periudhës së kundërshtimit.* Rrjedhimisht pala ankuese nuk ka mundur të votoj në vendvotimin brenda Kosovës për raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune të datës 09 nëntor 2025.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli vlerëson se ankuesit, KQZ i ka dërguar fletëvotimin e parë i cili nuk ka qenë i komunës përkatëse për të cilën ushtron të drejtën e votës. Pas komunikimit të palës ankuese me KQZ, palës i është dërguar fletëvotimi i komunës së Prishtinës të cilin pala e ka pranuar me datën 9 Tetor 2025 në ora 09:48, pra para së të përfundoj periudha e votimit jashtë Kosovës me datën 11 Tetor 2025.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës ka qenë i informuar nga KQZ, përmes email adresës ashtu si çdo votues i regjistruar për votim jashtë Kosovës, se në momentin e aprovimit të kërkesës për regjistrim, emri i tij apo saj do të largohet nga lista e votuesve brenda Kosovës siç parashihet me nenin 96 paragrafi 9 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3, neni 96 paragrafi 9 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 7 paragrafi 6 e Rregullores

Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosove, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.424/2025, datë 10.11.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike; kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LVP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.